



URDHËR

Nr. 116, Datë 29/10/2015

PËR

PËRJASHTIMIN DHE REDUKTIMIN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT TË STUDENTËVE QË NDJEKIN PROGRAMET E STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË TË CIKLIT TË PARË, TË STUDENTËVE QË NDJEKIN PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË "MASTER PROFESIONAL" DHE "MASTER I SHKENCAVE"/"MASTER I ARTEVE TË BUKURA" NË FAKULTETET E UNIVERSITETIT TË ARTEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2015 - 2016

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", pika 4, shtojca 1/2 dhe shtojca 1/3, të VKM nr.866, datë 23.10.2015, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015-2016", **Udhëzimit nr.52**, datë 03.11.2014, "Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe të regjistrimit për kandidatët me statusin e ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politik nga sistemi komunist, të verbrit, të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të jetimit, si dhe romët dhe ballkano-Egjiptianët, për programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave"/"Master i Arteve të Bukura", për vitin akademik 2014-2015", nenit 39 të Statutit të Universitetit të Arteve,

URDHËROJ

1. Studentët që ndjekin programet e studimeve me kohë të plotë të ciklit të parë, (Bachelor), në Fakultetet e UART, për vitin akademik 2015-2016 (shtojca 1/2), që vijnë nga shtresa sociale të mëposhtme **nuk e paguajnë tarifën e shkollimit:**
 - a) personat që nuk shikojnë/dëgjojnë;
 - b) invalidët e punës dhe fëmijët e tyre;
 - c) invalidët;
 - ç) invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe fëmijët e tyre;
 - d) jetimët;
 - dh) romët;
 - e) ballkano - egjiptianët;
 - ë) personi, njëri nga prindërit e të cilit është ndarë nga jeta, dhe familja, në këtë rast, përfiton ndihmë ekonomike nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore;
 - f) ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë nga sistemi komunist ose fëmijët me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;
 - g) fëmijët e policëve dhe të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, si dhe fëmijët e punonjësve të Gardës së Republikës, të punonjësve të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të punonjësve të policies së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, kur punonjësit kanë humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës,
 - gj) të prekurit nga HIV/AIDS.



Handwritten signature and date: 29-10-2015



2. Studentët që ndjekin programet e studimeve me kohë të plotë të ciklit e dytë, "Master Profesional" ose "Master i Shkencave"/ "Master i Arteve të Bukura", në Fakultetet e UART, për vitin akademik 2015-2016, (*shtojca 1/3*) që vijnë nga shtresa sociale të mëposhtme, **paguajnë 50 % të tarifës së shkollimit:**

- a) personat që nuk shikojnë/dëgjojnë;
- b) invalidët e punës dhe fëmijët e tyre;
- c) invalidët;
- ç) invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe fëmijët e tyre;
- d) jetimët;
- dh) romët;
- e) ballkano - egjiptianët;
- ë) personi, njëri nga prindërit e të cilit është ndarë nga jeta, dhe familja, në këtë rast, përfiton ndihmë ekonomike nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore;
- f) ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë nga sistemi komunist ose fëmijët me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;
- g) fëmijët e policëve dhe të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, si dhe fëmijët e punonjësve të Gardës së Republikës, të punonjësve të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të punonjësve të policies së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, kur punonjësit kanë humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës;
- gj) të prekurit nga HIV/AIDS.

3. **Miratimi i modelit të Kërkesës** për përjashtimin ose reduktimin 50% nga tarifa vjetore e shkollimit të studentëve në UART për vitin akademik 2015 – 2016, lidhja nr.1, bashkëlidhur këtij urdhri.

4. Aplikimet përfundimtare nga studentët, që aplikojnë për mos pagesë të tarifës së shkollimit ose reduktimin 50%, sipas përcaktimit të pikës 1, 2, 3, të këtij urdhri, duhet të bëhen deri në **datën 01 dhjetor 2015, ora 14 -⁰⁰**, pranë **Zyrës së Sektorit Mësimor & Informimit** të UART.

Procedura e aplikimit dhe urdhri i pranimit ose jo të aplikimit, **duhet të përfundojë brenda 30 ditëve**.

5. Studentët, që aplikojnë për përjashtimin ose reduktimin 50% nga tarifa vjetore e shkollimit, kërkesën sipas modelit të miratuar dhe dokumentacionin shoqëruar justifikues zyrtar, **i dorëzojnë tek Zyra e Sektorit Mësimor & Informimit të UART**, të cilat i protokollojnë, sipas modelit, bashkëlidhur.

Përgjegjësi i Sektorit Mësimor & Informimit të UART, kërkesat e studentëve dhe dokumentacionin justifikues zyrtar, **i dorëzojnë dorazi pranë Zyrës së Informacionit të Statistikës të UART**.

6. Përgjegjësia e Zyrës së Informacionit të Statistikave pranë Rektoratit të UART, aplikimet e studentëve të dorëzuara nga Përgjegjësi i Sektorit Mësimor & Informimit të UART, i regjistron sipas rregullave të protokollimit, modeli bashkëlidhur.

7. Përgjegjësja e Zyrës së Informacionit të Statistikave pranë Rektoratit të UART, aplikimet e studentëve ja dorëzon dorazi Juristit të UART, rregullisht çdo ditë por jo më vonë se 3 ditë nga dita e dorëzimit nga Përgjegjësi i Sektorit Mësimor & Informimit të UART.





Përgjegjësja e Zyrës së Informacionit të Statistikave pranë Rektoratit të UART, përgatit tabelat përkatëse për të gjithë aplikantët, përfitues ose jo, për pagesën e tarifës së shkollimit për vitin akademik 2015-2016, modeli bashkëlidhur.


8. Juristi i UART, përgatit projek - urdhrin e Rektorit të UART, për pranimin ose jo të aplikimit të studentëve, në vazhdimësi, brenda një kohe të arsyeshme.
Për çdo aplikant student, urdhëri për pranimin ose jo të aplikimit do të jetë i arsyetuar dhe i veçantë.
Projek - urdhrin e Rektorit të UART, për pranimin ose jo të aplikimit të studentëve Juristi i UART i dorëzon dorazi tek Përgjegjësi i Zyrës së Informacionit të Statistikave pranë Rektoratit të UART, i cili i dorëzon tek Rektori;
Urdhërat e firmosur nga Rektori dhe vulosur në protokollin e Rektoratit, shpërndahen sipas këtij urdhri nga Përgjegjësi i Zyrës së Statistikës pranë Rektoratit të UART.
Në fund të përfundimit të të gjithë procedurës, sipas këtij urdhri, i gjithë dokumentacioni i aplikimeve dhe urdhërave të Rektorit, Përgjegjësi i Zyrës të Informacionit të Statistikave pranë Rektoratit të UART, me procesverbal i dorëzon në protokollin e UART.
9. Urdhri t'u bëhet i ditur: Kancelarit, Dekanëve të Fakulteteve, Drejtorisë Ekonomike dhe studentit aplikant.
10. Në çdo rast, kur një aplikues student mund të ketë përfituar mos pagesën e tarifës së shkollimit ose reduktimin e saj, për vitin akademik 2015-2016, me dokumentat shoqërues justifikues, që në të ardhmen rezultojnë jo ligjore, përgjegjësia bije mbi studentin i cili do të penalizohet sipas legjislacionit në fuqi.
11. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve nga sektori i IT, i UART;
K/Sekretaret e Fakulteteve dhe sektori mësimor orjetojnë studentët që të shkarkojnë **modelin e kërkesës** nga faqja zyrtare e UART www.uart.edu.al, në rubrikën "Njoftime" ose rubrikën "Studenti".
12. Mos aplikimi në afatet e parashikuara nga ky urdhër, mos dorëzimi i të gjitha dokumentave, sipas pikës 3 të këtij urdhëri (**modeli i kërkesës**), dhe pikës 4 të këtij urdhri, **e bën të pavlefshëm aplikimin.**
13. Çdo student aplikues, në rast se i refuzohet kërkesa për mos pagesën e tarifës së shkollimit ose reduktimit të saj, ka të drejtë të ankohet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
14. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri, Dekanët e Fakulteteve, Kancelari, Drejtoria Ekonomike, K/Sekretaret e Fakulteteve, Sektori Mësimor, Sektori i Statistikës, sektori i IT, Juristi i UART dhe studenti aplikant.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Prof. Petrit MALAJ

REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE



KËRKESE						REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I ARTEVE	
Për përjashtim ose reduktim 50% nga tarifa vjetore e shkollimit të studentëve në UART për vitin akademik 2015-2016.							
<p>Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", pika 4, shtojca 1/2 dhe shtojca 1/3, të VKM nr.866, datë 23.10.2015, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifën e shkollimit për vitin akademik 2015-2016", Udhëzimit nr.52, datë 03.11.2014, "Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe të regjistrimit për kandidatët me statusin e ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politik nga sistemi komunist, të verbrit, të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të jetimit, si dhe romët dhe ballkano-Egjiptianët, për programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave"/ "Master i Arteve të Bukura", për vitin akademik 2014-2015, dhe akte të tjera që i referohen tarifës vjetore të shkollimit. Kjo praktikë përfshin kërkesën e studentit, e cila duhet të plotësohet nga çdo student i cili pretendon se duhet të përjashtohet ose reduktim 50 % nga detyrimi për pagesën e tarifës vjetore të shkollimit.</p> <p>Kjo praktikë nuk përdoret për studentët që janë shtetas të huaj.</p>						Numri i protokollit plotësohet nga Përgjegjësi i Sektorit Mësimor & Informimit të UART	
						Nr. _____ prot.	
TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË STUDENTIT KËRKUES (Plotëso me germa të mëdha, vendos shenjën X, ose rumbullako)							
Emri				Data e kërkesës			
Mbiemri				Nr. i Letër njoftimit			
Atësia				Gjinia	M <input type="checkbox"/>	F <input type="checkbox"/>	
Datëlindja	/ /	/ /	/ / / /	Cikli i studimit	1	2	
	dita	muaji	viti	Viti i Studimit	1	2	
Fakulteti	FM	FAS	FAB	Programi i Studimit			
LLOJI I KËRKUAR I PËRJASHTIMIT NGA DETYRIMI PËR PAGESËN E TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT				I PLOTË	<input type="checkbox"/>	I PJESHËM (50 %)	<input type="checkbox"/>
<p>Unë aplikanti paraqes KËRKESE për përjashtimin ose reduktimin nga detyrimi për pagesën e tarifës vjetore të shkollimit, pasi jam student i Universitetit të Arteve dhe plotësoj kushtet e përcaktuara nga vendimet e Këshillit të Ministrave që rregullojnë tarifën vjetore të shkollimit në IAL Publike. Deklaroj se të dhënat e paraqitura nga ana ime në këtë kërkesë si dhe dokumentacioni shoqëruar që provon plotësimin e njërës prej kushteve të renditura në vijim në këtë kërkesë, janë, në dijeninë time, të sakta dhe janë dokumenta zyrtarë të marra nga institucionet shtetërore dhe/ose të njohura me ligj.</p> <p>Jam në dijeni se deklaratimet e rreme nga ana ime në këtë kërkesë si dhe paraqitja e dokumentave të falsifikuar, përveç përgjegjësisë penale, sjell automatikisht heqjen e të drejtës për përjashtim nga detyrimi për pagesën e tarifës vjetore të shkollimit dhe në këtë rast detyrimin tim që brenda 10 ditësh nga njoftimi i bërë nga strukturat e UART, të kryej pagesën e kësaj tarife, në të kundërt humbas të drejtën e vazhdimin të studimeve.</p>							



Dokumentat shoqëruese janë origjinale ose kopje të noterizuara.

KËRKUESI	NËNSHKRIMI
<hr/> Emri dhe mbiemri	
Kriteri 1	Student që vjen nga shtresa sociale: persona që nuk shikojnë/ nuk dëgjojnë;
<input type="checkbox"/>	Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm: 1. Fotokopje të kartës së ID; 2. Çertifikatë familjare e tre muajve të fundit; 3. Fotokopje e noterizuar e vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).
Kriteri 2	Student që vjen nga shtresa sociale: invalidë pune dhe fëmijët e tyre, invalidë paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe fëmijët e tyre;
<input type="checkbox"/>	Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm: 1. Fotokopje të kartës së ID; 2. Çertifikatë familjare e tre muajve të fundit; 3. Fotokopje e noterizuar e vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP). 4. Fotokopje e noterizuar të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).
Kriteri 3	Student që vjen nga shtresa sociale: jetimë;
<input type="checkbox"/>	Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm: 1. Fotokopje të kartës së ID; 2. Çertifikatë familjare e tre muajve të fundit; 3. Fotokopje e noterizuar e dokumentit që certifikon statusin e jetimit të të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.
Kriteri 4	Student që vjen nga shtresa sociale: fëmijë romë / ballkano egjiptianë
<input type="checkbox"/>	Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm: 1. Fotokopje të kartës së ID; 2. Çertifikatë familjare e tre muajve të fundit; 3. Duhet të dorëzojë, të noterizuar dokument vëtdëklarim që vërteton që është romë ose ballkano – egjiptianët.
Kriteri 5	Student që vjen nga shtresa sociale: njëri nga prindrit e të cilit është ndarë nga jeta, dhe familja, në këtë rast, përfiton ndihmë ekonomike nga njësia përkatëse e qeverisë vendore;
<input type="checkbox"/>	Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm: 1. Fotokopje të kartës së ID; 2. Çertifikatë familjare e tre muajve të fundit dhe çertifikatë vdekje të prindrit; 3. Vërtetim nga Njësia e Qeverisjes Vendore që përfiton ndihmë ekonomike.
Kriteri 6	Student që vjen nga shtresa sociale: ish – të dënuar dhe të përndjekur politik nga sistemi komunist ose fëmijët me prindër të dënuar politik me heqje lirie;
<input type="checkbox"/>	Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm: 1. Fotokopje të kartës së ID; 2. Çertifikatë familjare e tre muajve të fundit;



	<p>3. Për ish të dënuarit, fotokopje e njësuar në Republikën e Shqipërisë të dokumentit që vërteton statusin e ish – të dënuarit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;</p> <p>4. Për ish të përndjekurit politik fotokopje e njësuar në Republikën e Shqipërisë të dokumentit që vërteton statusin e ish-të përndjekurit të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.</p>
Kriteri 7	Student që vjen nga shtresa sociale: fëmijët e policëve dhe të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, si dhe fëmijët e punonjësve të Gardës së Republikës, të punonjësve të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të punonjësve të policies së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, kur punonjësit kanë humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës;
<input type="checkbox"/>	<p>Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fotokopje të kartës së ID; 2. Çertifikatë familjare e tre muajve të fundit; 3. Dokument zyrtar nga Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, ose institucioni shtetëror përkatës.
Kriteri 8	Studentë të prekur nga HIV/AIDS:
<input type="checkbox"/>	<p>Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fotokopje të kartës së ID; 2. Çertifikatë familjare e tre muajve të fundit; 3. Fotokopje të noterizuar të dokumentin mjekësor.
KËRKUESI	NËNSHKRIMI
<p>_____</p> <p>Emri dhe mbiemri</p>	

[Handwritten signature]

